

## SPECIFIKIMET TEKNIKE

Pershkrimi dhe sasia e mallrave: sipas listes bashkelidhur dokumentacionit te tenderit  
Ofertuesi duhet te plotesoje tabelen me çmim per njesi, prodhuesin dhe origjinen per sejcilin mall (pajisje mjekesore) te ofruar.

Pervec specifikimeve teknike te percaktuara ne tabele **ofertuesi** duhet te paraqese:

1. Autorizim Prodhuesi me ane te se ciles autorizohet per te tregetuar mallrat e Prodhuesit, per mallrat objekt prokurimi.
2. Prodhuesi i mallrave objekt prokurimi duhet te jete i certifikuar me ISO.
3. Te gjithë mallrat e ofruara duhet te jene produkte te çertifikuara me normen **C.E.** Certifikata CE e mallrave (pajisje spitalore) te jete e perkthyer ne shqip dhe e noterizuar.
4. Instalimi dhe venia ne pune e pajisjeve spitalore ( mallit ) do te kryhet me shpenzimet dhe nga shitesi ne perputhje me standartet nderkombetare te referuara me siper, duke ju pershtatur edhe sistemeve aktuale qe perdoren ne Institucionin tone. Shitesi duhet te marre persiper plotesimin e pajisjeve spitalore me aksesoret dhe pjeset e konsumushme te nevojshme (sipas normativave te prodhuesit) per te siguruar punen me ngarkesen e parashikuar gjate periudhes nje vjecare te garancise, kjo ne funksion te qellimit per te cilen do perdoret pajisja spitalore.
5. Te zhvilloje kurse trajnimi per inxhinierin dhe teknikun klinik si dhe perdoruesin e pajisjes spitalore.
6. Pajisja spitalore ( malli ) ne momentin e dorezimit te shoqerohet me manuale perdorimi ne gjuhen angleze 1(nje) cope si dhe 1(nje) manual servisi ne gjuhen angleze.
7. Pajisja spitalore ( malli ) ne momentin e dorezimit te shoqerohet me dokumentin e garancise, i cili te jete jo me pak se 1 ( nje ) vit garanci.
8. **Ofertuesi duhet te paraqese kataloget origjinale te pajisjes spitalore qe ofron, ne te cilen te jepen foto dhe specifikimet teknike te tyre, ne gjuhen angleze ose shqiptare, te markuara.**

## SASIA DHE GRAFIKU I LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

**Bashkelidhur DST-ve**

**Afatet e lëvrimit: nga momenti i lidhjes se kontrates deri ne 60 dite kalendarike.**